; **Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina

PRISHTINA

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 17, shkronja **b** të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), nenit 17 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 04/L-174, korrik 2013), nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja **b**, dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2017,merr këtë

V E N D I M
PËR BASHKIMIN E BLLOQEVE: "F-6", "F-16", "F-17" NË KUADËR TË PLANIT RREGULLUES URBAN "PRISHTINA E RE - PERËNDIM"

Neni 1
Lloji i dokumentit

Miratohet Vendimi për bashkimin e blloqeve: "F-6", "F-16", "F-17", të cilat gjenden në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e Re - Perëndim", në Prishtinë.

Neni 2
Qëllimi

Ndryshimi i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, ka për qëllim bashkimin e blloqeve: "F-6", "F-16" dhe "F-17", në një bllok të vetëm: F-18, ndryshim i cili do të vlejë deri në revidimin dhe miratimin e planit nga ana e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në harmoni me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për planifikim hapësinor.

Neni 3
Organet për zbatim

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. Organet e tjera përkatëse kompetente, do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij vendimi nga përgjegjësitë e tyre të parapara sipas Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale.

Neni 4
Përmbajtja

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa tekstuale dhe grafike e bashkimit të tri blloqeve.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 350/05-0182445/17, më 26.07.2017.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PRISHTINËS
DREJTORIA E ADMINISTRATËS
DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
OPŠTINA PRIŠTINA
REPUBLIKA KOSOVA

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.